



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

UP1 Nr:08-159
31.05.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-159 datë 17.05.2024 dhe Propozimin PA1 nr.08-159 datë 30.05.2024, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-2576/3 datë 31.05.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 25-të mbajtur më 31.05.2024, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) JON-RADIO SHPK Strugë, PA1 nr.08-301 datë 01.09.2023.

Arsyetim

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 22-të mbajtur më 20.05.2024, me Konkluzion ark.nr.02-2453/3 datë 20.05.2024, miratoi Propozimin e Drejtorit, PA1 nr.08-159 datë 17.05.2024 dhe inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, PA1 nr.08-301 datë 01.09.2023, për shkak se pas mbikëqyrjes së kryer të rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-2442/1 datë 16.05.2024, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), gjegjësisht nuka ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë me datë 21.05.2024, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.08-159 datë 21.05.2024, për njoftim se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miraton vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 30.05.2024 drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga ana e Sektorit për financa dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftimi me ark.nr.05-2574/1



**Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги**

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

datë 30.05.2024, se SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, më datë 30.05.2024 ka krye pagesë në shumë prej 787.668,00 (shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) denarë, me të cilën kompensimin e lejes për transmetim në radio e pagoi plotësisht (në tërësi).

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-159 datë 17.05.2024 dhe Propozimin PA1 nr.08-159 datë 30.05.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-2576/3 datë 31.05.2024, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 25-të mbajtur më 31.05.2024, miratoi të ndalon procedurën e inicuar për heqjen e lejes.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, është marrë vendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: neni 8 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).